



Prishtinë, 15 qershor 2012
Kodi i ZRRE-së: V_403_2012

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Bazuar në:

- Dispozitat e Nenit 14.4.1 dhe Nenin 25 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 03/L-185);
- Dispozitat e Nenit 39 të Rregullës për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë;
- Dispozitave të Nenit 8 të Licencës për Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes dhënë KEK sh.a;
- Vendimit për transferim të aseteve nga KEK Sh.a në KOSTT sh.a i Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr. 10/29 i datës 03.08.2011;
- Marrëveshjes për transferim të aseteve të lidhur mes KEK sh.a dhe KOSTT sh.a e datës 29.02.2012;
- Kërkesës për transferim të aseteve të KEK sh.a të datës 13.03.2012,

në seancën e mbajtur me datë 15 qershor 2012, nxori këtë:

VENDIM

- I. APROVOHET** transferi i aseteve 400/220/110 kV duke përfshirë edhe transformatorët 220/35/10 (20) kV, si dhe tokave, ndërtesave, pajisjeve ndihmëse dhe punësuarve nga KEK sh.a në KOSTT sh.a.
- II.** Regjistri i të gjitha asteve të transferuara nga KEK sh.a në KOSTT sh.a. i përpiluar me datë 30.03.2012 nga ekspertët e KEK dhe KOSTT, do të jetë shtojcë e këtij Vendimi.

Arsyetim

- Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) me datë 13.03.2012 nga KEK sh.a ka pranuar Kërkesës për transferim të aseteve në KOSTT sh.a. Kërkesës i janë bashkangjitur Vendimit i Qeverisë së Republikës së Kosovës për transferim të aseteve nga KEK-u në KOSTT, Marrëveshja e lidhur mes KEK dhe KOSTT me të cilën pajtohen për transferimin e aseteve të përfshira në marrëveshje dhe Regjistri i aseteve që do të transferohen i punuar nga nëngrupi punues teknik KEK-KOSTT.
 - ZRRE, pas vlerësimit të Kërkesës së KEK sh.a si dhe dokumenteve tjera të bashkangjitura, dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në diapozitiv të këtij vendimi.
- III.** Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërpunueshmërisë midis versioneve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV.** Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.



Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimet të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Bordi i ZRRE-së

Enver Halimi, kryesues

Përparim Kabashi, anëtar

Blerim Koci, anëtar

Merita Kostari, anëtare

Krenar Bujupi, anëtar